L I G J
Nr.9024, datë 6.3.2003

PËR AKREDITIMIN E LABORATORËVE TESTUES, KALIBRUES, ORGANIZMAVE CERTIFIKUES DHE INSPEKTUES NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton rregullat për krijimin dhe funksionimin e sistemit të akreditimit, përcakton fushat ku kryhet akreditimi dhe rolin e akreditimit në procedurat e vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike.

Neni 2
Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akreditim" kuptohet procedura e njohjes zyrtare, nga një organizëm i autorizuar, të kompetencës së një organizmi të vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike, për të kryer detyra të tilla, si testim, kalibrim, certifikim, inspektim.

2. “Autorizim" kuptohet dhënia e së drejtës për të kryer vlerësimin e përputhjes me standardet dhe rregullat teknike të produkteve, proceseve, shërbimeve në sferën e detyrueshme, organizmave publikë ose privatë, vendas ose të huaj, që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, nga ministritë dhe institucionet qendrore të fushës përkatëse.

3. “Certifikatë akreditimi" kuptohet dokumenti në bazë të të cilit tregohet kompetenca në kryerjen e detyrave të veçanta, në fushën e vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike.

4. “Certifikim" kuptohet veprimtaria e një pale të tretë e të pavarur, e cila vërteton nëse procesi, shërbimi ose produkti në fjalë plotëson kërkesat e veçanta të standardeve përkatëse, rregullat teknike ose aktet normative në fuqi.

5. “Inspektim" kuptohet veprimtaria që kryhet për të vlerësuar fazat e projektimit të produktit, procesit dhe shërbimit, në përputhje me kërkesat konkrete, në bazë të gjykimit profesional ose të kritereve kryesore.

6. “Kalibrim" kuptohet tërësia e veprimeve që përcakton, në kushte të veçanta, marrëdhënien ndërmjet vlerave të treguara nga një mjet matës ose sistem matës, ose të vlerave të dhëna nga një matje materiale, si dhe vlerave të njohura, korresponduese të mjetit të matur.

7. “Organizëm i vlerësimit të përputhjes" kuptohet organizmi publik ose privat, i propozuar nga ministria ose institucioni tjetër qendror përkatës, i miratuar nga Këshilli i Ministrave.

8. “Sferë e detyruar" kuptohet sfera, subjekt i vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike, të detyrueshme të produkteve, proceseve dhe shërbimeve, si siguria e jetës, mbrojtja e shëndetit dhe e mjedisit.

9. “Testim" kuptohet veprimtaria teknike, që ka të bëjë me përcaktimin e një ose më shumë karakteristikave të një produkti, materiali, pajisjeje, organizmi, fenomeni fizik, procesi ose shërbimi të dhënë, sipas një procedure të veçantë.

10. “Vlerësim përputhjeje" kuptohet veprimtaria, e cila ka për qëllim përcaktimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për të vërtetuar nëse është plotësuar tërësia e kërkesave të një përcaktimi teknik apo standardi.

KREU II
ORGANIZIMI

Neni 3
Drejtoria e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë

Për kryerjen e funksioneve të akreditimit krijohet Drejtoria e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë, e cila më poshtë do të quhet Drejtoria e Akreditimit. Organizimi dhe funksionimi i saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4
Varësia dhe drejtimi

1. Drejtoria e Akreditimit është institucion buxhetor, në varësi të Ministrit të Ekonomisë.
2. Ajo drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Statusi i Drejtorit të Përgjithshëm dhe i punonjësve të Drejtorisë së Akreditimit rregullohet me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Neni 5
Detyrat e Drejtorisë së Akreditimit

Drejtoria e Akreditimit ka këto detyra:
a) akreditimin e laboratorëve të testimit/provave;
b) akreditimin e laboratorëve kalibrues;
c) akreditimin e organizmave certifikues;
ç) akreditimin e organizmave inspektues;
d) mbikëqyrjen e organizmave të akredituar;
dh) ndërprerjen dhe tërheqjen e akreditimit;
e) përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë për akreditimin;
ë) bashkëpunimin me organizmat kombëtarë të akreditimit në vendet e tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë, rajonale ose ndërkombëtare, ose për të arritur marrëveshje dypalëshe;
f) dhënien e këshillave në administratën shtetërore për çështje që lidhen me akreditimin dhe vlerësime të tjera të kompetencës teknike, për kryerjen e procedurave të vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike;
g) mbajtjen, azhurnimin dhe dhënien e informacionit për statusin e akreditimit të organizmave të akredituar;
gj) bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, ministritë përkatëse dhe shoqatat e interesuara për çështjet e akreditimit.

KREU III
PARIMET E AKREDITIMIT

Neni 6
Bazat ligjore

Akreditimi në Republikën e Shqipërisë bazohet në legjislacionin në fuqi, në standardet ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë dhe dokumente të tjera të nxjerra nga organizmat ndërkombëtarë të akreditimit.

Neni 7
Parimet e akreditimit

Akreditimi bazohet në parimet e paanshmërisë, transparencës dhe përgjegjësisë profesionale. Drejtoria e Akreditimit është e pavarur nga çdo organizëm i vlerësimit të përputhjes në standardet dhe rregullat teknike dhe ajo nuk përfshihet në këto veprimtari.

Neni 8
Vlerësimi i aftësisë dhe i përgjegjësisë teknike

Drejtoria e Akreditimit vlerëson aftësinë teknike të organizmave të vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike, e cila merret për bazë në dhënien e autorizimit nga organet përkatëse. Ato bëjnë vlerësimin e statusit ligjor dhe aftësisë ekonomike të tyre.

Neni 9
Akreditimi nga organizma ndërkombëtarë

Akreditimi për organizmat e vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike mund të kryhet edhe nga organizma të huaj akreditimi, të cilët janë anëtarë të marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë, rajonalë ose ndërkombëtarë, ku edhe Drejtoria e Akreditimit është anëtare ose me të cilat ajo ka marrëveshje dypalëshe.

Neni 10
Tarifat e akreditimit dhe miratimi i tyre

Tarifat për kryerjen e të gjitha shërbimeve nga Drejtoria e Akreditimit propozohen nga kjo e fundit dhe miratohen nga Ministri i Financave. Këto tarifa janë të njëjta, si për subjektet vendase, ashtu dhe për ato të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

Neni 1
Shpenzimet e akreditimit

Akreditimi kryhet në bazë të kërkesave të palëve të interesuara.

2. Të gjitha shpenzimet për akreditimin dhe mbikëqyrjen, në përputhje me standardet dhe procedurat përkatëse, mbulohen nga pala e interesuar që ka bërë kërkesë, sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Financave.

3. Të ardhurat e siguruara nga këto shërbime derdhen në Buxhetin e Shtetit.

KREU IV
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 12
Kundërvajtjet

Përdorimi i stemës së akreditimit nga subjekte të paakredituara apo që u ka mbaruar afati i akreditimit përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 5 000 (pesë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, prej punonjësit të autorizuar nga Drejtoria e Akreditimit.

Neni 13
Ankimi administrativ

1. Kundër vendimit të dënimit administrativ mund të bëhet ankim te Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit brenda 15 ditëve. Ai duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve nga data e ankimit.

2. Kundër vendimit të Drejtorit të Drejtorisë së Akreditimit ose kur ai nuk përgjigjet mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 14

1. Sektori i Akreditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimeve do të kryejë veprimtarinë e akreditimit derisa të fillojë të funksionojë Drejtoria e Akreditimit.

2. Procedurat e akreditimit, të filluara përpara miratimit të akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave, do të kryhen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 15

1. Në ligjin nr.8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", bëhen këto ndryshime:

a) në nenin 1, fjalia "Akreditimit të laboratorëve të provave, organizmave certifikues të produkteve, sistemeve të cilësisë, personelit dhe organizmave inspektues" shfuqizohet;

b) neni 2 shfuqizohet;

c) në nenin 7, fjalia "Për drejtimin, organizimin dhe kontrollin e punës për akreditimin", shfuqizohet;

ç) në nenin 9:

(i) në pikën 2 fjalia "Ndjekjen e procedurave të akreditimit" shfuqizohet;

(ii) pika 5 shfuqizohet;

(iii) në pikën 8 fjalia "Lidhjen e marrëveshjeve me organet homologe për njohjen e ndërsjellë të raportanalizave të laboratorëve të akredituar" shfuqizohet.

Neni 16
Dispozita të fundit

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3 dhe 14 të këtij ligji.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekret nr.3765, datë 27.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu